

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:026334

Datë: 19.09.2019

Numri i dokumentit: 00528667

PKR. 99/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA-sipas gjyqtarit Ibrahim Idrizi, kryetar i trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 281 par.1 nën par.1.7 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, PPI.nr.28/18, të datës 11.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më 28 gusht 2019, në prani të Prokurorit të shtetit Veton Shabani, të akuzuarit dhe avokatit A.I., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërkaq më 13 shtator 2019, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.B., i biri i H dhe nënës B., e vajzërisë A., i lindur më-identifikohet me nr.personal:....., në fsh. Komuna Ferizaj, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar përkohësisht në shtetin e Gjermanisë, ku atje ka vendqëndrim të përkohshëm, i martuar, pa fëmijë, me gjendje të mesme ekonomike, ka qëndruar në paraburgim prej datës 17.01.2018 deri më 26.01.2018,tani mbrohet në liri,

Ë s h t ë f a j t o r

Se më 17 janar 2017, rreth orës 15:40 min në Ferizaj, në afërsi të oborrit të shkollës ekonomike "Faik Konica", gjatë kontrollës nga të ushtruar nga Policia e R. Kosovës—sektori

antidrogë, në gjepin e sakos së të akuzuarit, kanë gjetur narkotikë të llojit marihuanë në peshë prej 13.33 gram dhe një pako rizlla (për mbështjellje të narkotikut), e që e kishte marr nga i mituri L.M., sasinë e narkotikut e ka poseduar në mënyrë të pa ligjshme dhe pa autorizim e me qëllim që ta shes apo shpërndaj e që narkotiku sekuestrohet nga policia,

me këtë kreu veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të, lidhur me nenin 281 par.1 nën par.1.7 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7,17,21,41,43, 45,46,47,73,75,76,83,273 e 281 të KPRK-së, si dhe të nenit 365 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim në bazë të nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit zëvendësohet me dënim gjobe në shumë prej 2.000€, si dhe dënim gjobe në shumë prej 400€.

Në dënimin e caktuar me burgim – të zëvendësuar me dënim gjobe, i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 17 janarit 2018 deri më 26 janar 2017, kurse pjesën tjetër të dënimit do ta paguaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet në asnjërën prej formave të parapara në nenin 46 të KPRK-së, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim burgimi në atë mënyrë që për çdo 20 Euro do të llogaritet nga një ditë burgimi.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme narkotiku i llojit marihuanë në peshë prej 13.33 gram.

Obligohet që kësaj Gjykate të ia paguaj paushallin gjyqësor në shume prej 30€, si dhe shumën prej 50€, në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

I. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/L.nr. 28/18, të datës 11.06.2018, e ka akuzuar N.B. për kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1, lidhur me nenin 281 par.1 nën par.1.7 të KPRK-së.

Duke vepruar sipas kësaj akuze, është mbajtur shqyrtimi fillestar sipas dispozitave të nenit 245 të KPPK-së.

II. Pranimi i fajësisë nga i akuzuari

I akuzuari N.B., në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 ,lidhur me nenin 281 par.1 nën par.1.7 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë me aktakuzën e Prokurorit të shtetit. Ka deklaruar se ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e bën në mënyrë vullnetare dhe është konsultuar mjaftueshëm me avokatin mbrojtës, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, duke premtuar se nuk do te kryej vepër të tillë e as vepër tjetër penale.

III. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Kryetari i trupit gjykues në shqyrtimin fillestar konstatoi se i akuzuari e ka pranuar fajësinë pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatin si dhe pranimi i fajit është mbështetur në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë, së aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe me këtë janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 248 të KPPK-së, dhe në këtë mënyrë shqyrtimin fillestar e ka përfunduar pa administruar provat e tjera dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 248 të KPP-së

IV. Vlerësimi ligjor i veprimeve të të akuzuarit

Kryetari i trupit gjykues po ashtu konstatoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 të, lidhur me nenin 281 par.1 nën par.1.7 të KPRK-së, për të cilën veprë i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe fajtor, andaj edhe u dënua si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

V. Vlerësimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 i KPPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marr për bazë pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, në kohën e kryerjes së veprës ka qen i moshës relativisht të re (23)vjeçar, nuk ka kryer ndonjë veprë tjetër penale, nuk është hasur brenda oborrit të shkollës “Faik Konica”, por ishte duke ecur nëpër trotuar të rrugës-përkaj oborrit të shkollës, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh, vendin e kryerjes së veprës penale nga neni 273 dhe si rrethana cilësuese pati për bazë se është kryer brenda një perimetri të afërt me oborrin e shkollës, por jo në brendësi të oborrit të shkollës, vend ky ku nxënësit e frekuentojnë vazhdimisht, që do të cilësoj me rrethana cilësuese edhe pse është plotësuar kriteri formal-ligjor distanca në mes të vendit ku është hasur i akuzuari me narkotikë në gjep dhe oborrit të shkollës, andaj Gjykata pati për bazë rrezikshmërinë abstrakte të vlerës së mbrojtur me këtë veprë penale-shëndeti i personave në përgjithësi e në veçanti të personave të ndjeshëm siç janë nxënësit.

Gjykata është e bindur se dënimi me gjobë në shumë prej 2.400€, i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, andaj edhe përdori dispozitën e nenit 76 të KPRK-së për zbutjen e dënimit nën minimumin ligjor të paraparë për këtë veprë, duke pas parasysh përpos rrethanave lehtësuese të cekura por edhe sasinë e narkotikut, ashtu që dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, ia zëvendësoi në dënim gjobe në shumë prej 2,400€, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, pra do të ndikoj që i

akuzuari në të ardhmen të mos kryej vepra të tilla apo të tjera, njëherit do ti shërbej edhe preventivës gjenerale duke ndikuar te personat tjerë për të mos kryer vepra penale.

VI. Llogaritja e paraburgimit, Shpenzimet e procedurës penale dhe konfiskimi

Vendimi lidhur me llogaritjen e paraburgimit është i bazuar në nenin 83 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim është i bazuar në nenin 273 par.5 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 450 e 453 të KPPK-së, kurse vendimi për pagesën e shumës prej 50,000,000.00 Euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, bazohet në nenin 39 par.3 nën par.3. 2 të LKVK-së.

Nga te cekurat me larte u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR 99/2018**

Më 13 shtator 2019

Zyrtare ligjore,
Arbelinda Tahiri

Kryetari i trupit gjykues- gjyqtari,
Ibrahim Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në drejtim të sanksionit penal, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.